

AMF informon Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me zgjidhjen e problematikës së Fondit të Kompensimit

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për janar-gusht 2018

Zhvillime të tjera

- AMF, takim me përfaqësues të Bankës Botërore
- Autoriteti njofton qytetarët ti drejtohen Byrosë Shqiptare të Sigurimit për t'u informuar mbi dosjet e tyre, objekt i Fondit të Kompensimit
- Workshop i 3-të kombëtar i projektit për sigurimet vullnetare gjithëpërfshirëse
- Zhvillohet konferenca e katërt vjetore "Sigurimi në një të ardhme dixhitale"
- Zhvillohet shkolla ndërkombëtare verore me titull "Analiza e sigurimeve"

Edukimi i Konsumatorit


- Perspektiva e mbrojtjes sociale e reflektuar në mikrosigurime (pjesa e dytë dhe e fundit)

Lajme Ndërkombëtare

- Britani
- Greqi
- Hungari
- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Serbi
- Slloveni
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF informon Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me zgjidhjen e problematikës së Fondit të Kompensimit



Drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare informuan, në datë 12 shtator, Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me ecurinë e problematikës së Fondit të Kompensimit.

Drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare informuan, në datë 12 shtator, Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me ecurinë e problematikës së Fondit të Kompensimit. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi theksoi se gjatë vitit 2018, ashtu si edhe gjatë vitin të kaluar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i ka kushtuar një vëmendje të veçantë evidentimit dhe zgjidhjes së problemeve të trashëguara ndër vite (duke filluar nga viti 2002) me Byronë Shqiptare të Sigurimit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi se deri në datë 10 shtator 2018 shoqëritë e sigurimit kanë kryer 59% të pagesave të dëmeve të prapambetura nga Fondi i Kompensimit, që në vlerë absolute arrin në rreth 541 milionë lekë dëmshpërblime, të cilat janë marrë nga qytetarët e dëmtuar.

Gjithashtu, shoqëritë e sigurimit kanë lidhur marrëveshje për të paguar me këste të nënshkruara me palët përfituese/përfaqësuesit ligjor edhe për shlyerjen e detyrimeve në vlerën prej rreth 303 milionë lekë. Në anën tjetër, AMF, pas ndryshimit të rregullores në muajin korrik 2018, ka shpërndarë te shoqëritë praktika për shlyerje detyrimesh në vlerën e mbi 95 milionë lekëve.

Kjo ecuri pozitive në pagesa vjen pas vendimeve të njëpasnjëshme të Bordit të AMF-së për pagesën e menjëhershme për detyrimet e prapambetura që janë të ekzekutueshme dhe miratimin e Fondit të Kompensimit për dosjet që janë në proces trajtimi, ose gjyqësor.

Në muajin nëntor 2017, u miratua një shtesë në Fondin e Kompensimit të vitit 2017, me vlerë 250 milionë lekë, e cila nuk vinte si propozim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Byrosë. Ndërsa në korrik 2018 Bordi miratoi një tjetër shtesë të Fondit të Kompensimit prej rreth 182 milionë lekë, nisur nga vendimet e gjykatave të formës së prerë. Fondi i Kompensimit i miratuar nga Bordi i Autoritetit për vitin 2018 arrin në rreth 1.68 miliardë lekë dhe ky Fond i miratuar nga AMF është më shumë se ai i 3 viteve të marra së bashku, 2014– 2016.

Nga ky fond i miratuar, 923 milionë lekë janë detyrimet e prapambetura, të cilat janë për t'u ekzekutuar dhe rreth 745 milionë lekë janë për ngjarjet e sigurimit në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë.

AMF edhe në vazhdim po merr një sërë masash lidhur me inspektimin në vazhdim të BSHS-së për ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Bordit të Autoritetit. Ndryshimet e ndodhura në BSHS me emërimin e drejtorit të ri dhe ndryshimin e rregullores “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, ndryshuar në korrik 2018, i dhanë mundësinë Autoritetit të bëjë ndarjen e dosjeve të prapambetura objekt i Fondin e Kompensimit në rastet kur nuk veprohet nga BSHS.

Ndërkohë, AMF ka rritur komunikimin me qytetarët dhe i fton ata në vazhdimësi që të komunikojnë me të si nëpërmjet nëpërmjet faqes zyrtare të AMF-së, www.amf.gov.al, adresës elektronike konsumatori@amf.gov.al për të prezantuar shqetësimet e tyre dhe për të marrë informacion lidhur me ecurinë e dosjeve të tyre. AMF e ka mbrojtjen e konsumatorëve një nga objektivat e saj prioritare.

Fondi i Kompensimit i miratuar nga Bordi i Autoritetit për vitin 2018 arrin në rreth 1.68 miliardë lekë dhe ky Fond i miratuar nga AMF është më shumë se ai i 3 viteve të marra së bashku, 2014– 2016.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2018

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-gusht 2018 kapën vlerën mbi 11.1 miliardë lekë, ose 5.75% më shumë se janar-gusht 2017. Gjatë muajit janar-gusht 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 845,399 me një rritje prej 6.18% krahasuar me janar-gusht 2017.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një ulje me 11.23% në krahasim me periudhën janar-gusht 2017. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 2.12 miliardë lekë, apo 69.42% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 6.28% gjatë periudhës janar-gusht 2018, krahasuar kjo me janar-gusht 2017.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 6.85 miliardë lekë gjatë periudhës janar-gusht 2018, duke shënuar një rritje prej 4.96% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 66.39% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 12% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës, ku vihet re një rritje prej 35.9% e volumit të primeve të shkruara bruto.


Gjatë muajit janar-gusht 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 845,399 me një rritje prej 6.18% krahasuar me janar-gusht 2017.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 2.16% krahasuar me janar-gusht 2017. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 60.63% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-gusht 2018

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore:



AMF, takim me përfaqësues të Bankës Botërore

Drejtori i Përgjithshëm
Ekzekutiv i Autoritetit të
Mbikëqyrjes
Financiare, Z. Ervin
Koçi priti në datë 10
shtator përfaqësuesin e
Bankës Botërore
Z. Mario Guadamillas.



Gjatë takimit me përfaqësuesit e Bankës Botërore

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi priti në datë 10 shtator përfaqësuesin e Bankës Botërore Z. Mario Guadamillas. Në këtë takim u diskutua në lidhje me ecurinë e projektit për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së me fokus tregun e kapitaleve, i financuar nga Sekretariati Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO), me asistencën e Bankës Botërore.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së i njohu përfaqësuesit e Bankës Botërore me punën e zhvilluar në Autoritet gjatë kësaj periudhe, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e tregut të kapitaleve në vend dhe hartimin e dy projektligjeve të reja, “Për titujt” dhe “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Z. Koçi i falenderoi përfaqësuesit e Bankës Botërore për mbështetjen e vazhdueshme në drejtim të Autoritetit në kuadër të kualifikimit profesional dhe zhvillimit të kapaciteteve mbikëqyrëse, si edhe për mbështetjen e dhënë në lidhje me draft ligjin për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Nga ana e tij, përfaqësuesi i Bankës Botërore u shpreh shumë i kënaqur me ecurinë e deritanishme të projektit për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së, me fokus tregun e kapitaleve dhe për bashkëpunimin me Autoritetin. Fokusi i Bankës Botërore do të jetë diversifikimi i sistemeve financiare dhe asistenca në fusha të ndryshme për t'i shërbyer më tej zhvillimeve në Shqipëri.

Në takim u diskutua mbi mundësitë e thellimit të bashkëpunimit përmes një projekti të ri për zhvillimin e tregjeve dhe mbikëqyrjes efektive të tyre.

—○○○—
Autoriteti njofton qytetarët që kanë problematika lidhur me dëme të prapambetura nga Fondi i Kompensimit të komunikojnë me BSHS. Stafi i Byrosë do t'i informojë dhe orientojë ata për shoqërinë e sigurimit tek e cila është deleguar praktika për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit të tyre.

Autoriteti njofton qytetarët t'i drejtohen Byrosë Shqiptare të Sigurimit për t'u informuar mbi dosjet e tyre, objekt i Fondit të Kompensimit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) i ka kërkuar në vazhdimësi Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) shpërndarjen e dosjeve për praktikën e miratuar, të papaguara, të cilat kanë vendim gjyqësor të formës së prerë, objekt i Fondit të Kompensimit.

Autoriteti njofton qytetarët që kanë problematika lidhur me dëme të prapambetura nga Fondi i Kompensimit të komunikojnë me BSHS-në. Stafi i Byrosë do t'i informojë dhe orientojë ata për shoqërinë e sigurimit tek e cila është deleguar praktika për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit të tyre. Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, lista e dosjeve nuk publikohet, por qytetarët e interesuar mund ta gjejnë informacionin e detajuar pranë BSHS.

Për çdo problematikë apo për më shumë sqarime në lidhje me këtë proces, çdo qytetar mund të komunikojë me email konsumatori@amf.gov.al, amf@amf.gov.al ose mund të paraqitet pranë zyrave të AMF-së.

AMF mbetet e angazhuar për mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e besimit të tyre në treg. Sikurse ka vepruar përmes shumë vendimeve të marra gjatë viteve 2017-2018, AMF vazhdon t'i kushtojë vëmendje mbrojtjes së interesave të qytetarëve.

Autoriteti kërkon bashkëpunimin e qytetarëve që ata të kontaktojnë me AMF për çdo problematikë lidhur me tregjet nën mbikëqyrje.

Workshop i 3-të kombëtar i projektit për sigurimet vullnetare gjithëpërfshirëse

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, zhvilloi në datat 11-12 shtator 2018 *workshop-in* e 3-të kombëtar në kuadër të projektit për sigurimin vullnetar gjithëpërfshirës. Projekti mbështetet nga partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë, si edhe nga Iniciativa për Akses në Sigurime (*Access to Insurance Initiative*). Ekipi pjesëmarrës në këtë projekt ka përfaqësues nga shoqëritë e sigurimit në vend, banka, institucione financiare që veprojnë në tregun e mikrofinancës, si edhe organizma të tjerë që kanë aktivitet në fushën financiare dhe të biznesit.

Gjatë këtij *workshop-i* tek pjesëmarrësit, u prezantua puna e ekipit të projektit për mbështetjen dhe zhvillimin e produkteve të mikrosigurimeve të fokusuara në fushën e bujqësisë. Të pranishëm në këtë *workshop* ishin edhe pedagogë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të cilët kanë mbështetur në një studim të posaçëm dhe në përvojën e tyre, dhanë opinione se si mund të zgjerohet më tej sigurimi në sektorin e bujqësisë.



Gjatë zhvillimit të workshop-it

Gjatë këtij workshop-i tek pjesëmarrësit, u prezantua puna e ekipit të projektit për mbështetjen dhe zhvillimin e produkteve të mikrosigurimeve të fokusuara në fushën e bujqësisë.

Gjithashtu, në kontekstin e rritjes së aksesit në financim për sektorin e bujqësisë, përfaqësuesit e institucioneve të mikrofinancimit në Shqipëri, shprehën opinionin e tyre pozitiv për nevojën e produkteve të reja në tregun e sigurimeve, me synim rritjen e përfshirjes së individëve dhe bizneseve të vogla e të mesme në skemat e sigurimeve.

Ekipi pjesëmarrës në këtë projekt po punon në disa drejtime, me qëllim ndërtimin e besimit, lidhjeve bashkëpunuese, krijimin e dialogut për sigurimet vullnetare dhe gjetjen e formave, skemave, produkteve të reja dhe aplikimin e tyre, me objektiv qasjen ndaj sfidës së rritjes së pjesëmarrjes së popullsisë së gjerë në skema sigurimesh vullnetare. Projekti ka filluar në fund të vitit 2017 dhe do të zgjasë deri në dhjetor 2018.

Zhvillohet konferenca e katërt vjetore "Sigurimi në një të ardhme dixhitale"

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN) zhvilloi në datë 13 Shtator 2018, në Ljublanë, Slloveni, konferencën e katërt vjetore me temë: "Sigurimi në një të ardhme dixhitale".

Gjatë zhvillimit të konferencës u diskutua mbi ndryshime në fushën e biznesit të sigurimeve dhe rregullimi e tij në një mjedis ku transformimi dixhital po bëhet efektiv. Fokusi kryesor ishte eksplorimi i pasojave të transformimit dixhital në këtë biznes.

Ndërsa dixhitalizimi përhapet pothuajse në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, teknologjitë e reja ngrenë sfida të ndryshme për kompanitë, siguruesit, konsumatorët dhe rregullatorët. Konferenca ka eksploruar ndikimin e rreziqeve kibernetike, mbrojtjen e të dhënave dhe të tjerëve në industrinë si tërësi, si dhe mbi konsumatorët.



Gjatë zhvillimit të konferencës me temë: "Sigurimi në një të ardhme dixhitale"

Konferenca ka eksploruar ndikimin e rreziqeve kibernetike, mbrojtjen e të dhënave dhe të tjerëve në industrinë si tërësi, si dhe mbi konsumatorët.

Një vend të veçantë zuri dhe përdorimi i teknologjive të reja, të cilat ofrojnë lehtësi përdorimi, akses në produktet e ofruara nga tregu i sigurimeve, larmishmëri produktesh të përshtatura sipas profilit të çdo konsumatori, si dhe përmirësimin e vendimmarrjeve apo evidentimit të risqeve.

Disa prej teknologjive të trajtuara ishin komunikimi automatik me konsumatorin për marketing, shitje online apo suport (*chatbot*), policat e dematerializuara (firma elektronike), sisteme autonome për efikasitet në vendimmarrje të kompanive apo rregullatorëve (*machine learning*) apo aplikimi i policave inteligjente (*smart contract me blockchain*).

Zhvillohet shkolla ndërkombëtare verore me titull "Analiza e sigurimeve"

Shoqata e Aktuarëve të Zvicrës (SAA) zhvilloi në datat 13-17 gusht 2018 në Lozanë, Zvicër, shkollën ndërkombëtare verore me titull "Analiza e sigurimeve" me pjesëmarrjen e mbikëqyrësve dhe ekspertëve të tregut të sigurimeve nga 30 vende të ndryshme të botës.

Temat kryesore që u trajtuan kishin të bënin me mënyrën e përcaktimit të primit të sigurimit dhe provigjoneve teknike me metodat e fundit aktuariale. Konkretisht, me anë të gjuhës së programimit R, u analizuan të dhënat në lidhje me produktin MTPL, dhe u trajtua si nga pikëpamja teorike ashtu dhe me shembuj konkret, përlllogaritja e primit të riskut dhe atij të sigurimit, duke përdorur një sërë faktorësh diskriminues vlerësimi.



Pjesëmarrësit në shkollën ndërkombëtare verore

U trajtuan gjithashtu vetitë e modelit të përgjithshëm linear, limitet e tij, si dhe nevoja e përdorimit të teknikave të reja me fokus aplikimin e tyre në klasifikimin e risqeve, përlogaritjen e provigjoneve teknike, si dhe përcaktimin e tarifave të primit të sigurimit për një portofol të caktuar.

Perspektiva e mbrojtjes sociale e reflektuar në mikrosigurime

Aksesi në sigurinë shoqërore është një e drejtë thelbësore e njeriut. Për më tepër që siguria shoqërore dhe mbrojtja sociale njihen si pjesë përbërëse të përpjekjeve globale për të ulur varfaërinë dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Skemat e mikrosigurimeve për shtresat e marginalizuara të shoqërisë po zhvillohen vullshëm nga shumë shtete. Komisioni Evropian ka realizuar një studim në lidhje me perspektivën e mbrojtjes sociale përmes mikrosigurimit për të shpjeguar nga afër këto skema.

Dokumenti ka për autorë Christian Jacquier, Gabriele Ramm, Philippe Marcadent dhe Valérie Schmitt-Diabate

(Pjesa e dytë dhe e fundit, me shkurtime dhe redaktime)

Mikrosigurimi si një mekanizëm për zgjerimin e mbrojtjes sociale ka avantazhet krahasuese përtej skemave klasike të sigurimeve shoqërore:

- Mikrosigurimi mund të prekë grupe të përjashtuara nga sigurimet shoqërore statutore, siç janë punëtorët e ekonomisë joformale dhe punëtorët ruralë;
- Kostot e shërbimeve të nevojshme për të arritur këto kategori mund të reduktohen, pasi skemat e mikrosigurimit operohen shpesh nga organizata të decentralizuara të shoqërisë civile, duke u mbështetur edhe në vetëmenaxhimin vullnetar, të cilat zbatohen në afërsi të popullatës së synuar;
- Përfitimet që vijnë nga skemat e mikrosigurimive shpesh hartohen të tilla që t'i shërbejnë drejtpërdrejt popullatës së synuar. Në disa raste ato konsultohen edhe me grupet e synuara p.sh. nëpërmjet anketave familjare;
- Skemat e bazuara në komunitet zakonisht hasin më pak probleme mashtrimesh dhe abuzimesh sesa sistemet e centralizuara të mbrojtjes sociale, pasi anëtarët shpesh e njohin njëri-tjetrin, i përkasin të njëjtit komunitet dhe ndajnë të njëjtat interesa. Megjithatë, skemat e bazuara në komunitet mund të kenë vështirësi në grumbullimin e kontributeve të rregullta, duke rezultuar në problemet e mbajtjes dhe sfidat e qëndrueshmërisë. Disa skema i menaxhojnë këtë çështje të rinovimeve të ulëta përmes kontratave të sigurimit në grup me grupe të organizuara profesionale (siç janë kooperativat).

Mikrosigurimi mund të prekë grupe të përjashtuara nga sigurimet shoqërore statutore, siç janë punëtorët e ekonomisë joformale dhe punëtorët ruralë

Zhvillimi i mëtejshëm i mikrosigurimit

Zhvillimi i mëtejshëm i mikrosigurimit nënkupton aktorë të ndryshëm duke përfshirë edhe promovuesit dhe operatorët e skemave, si dhe shtetin.

Menaxhimi i këtyre skemave duhet të bëhet profesionalisht për të mundësuar rritjen dhe kompleksitetin e përbushjes së nevojave të grupit të synuar. Një mënyrë për të bërë këtë është që të transferojmë disa funksione të menaxhimit tek organizatat e specializuara. Kjo mund të nënkuptojë edhe ngritjen e skemave të reja që synojnë anëtarët e organizatave të mëdha si sindikatat, kooperativat dhe shoqatat profesionale. Skema më të mëdha janë në gjendje të ofrojnë mbulim më të plotë dhe ato shpesh janë më shumë të qëndrueshme pasi ato mund të krijojnë rezerva financiare me më shumë lehtësi.

Përfundime

Mikrosigurimi është një instrument që mund të përdoret për të zgjeruar mbrojtjen sociale të shtresave të përjashtuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në situata ku qeveritë nuk kanë burime dhe kapacitete për të ofruar mbrojtje sociale.

Mikrosigurimi kërkon një qasje dinamike, për të arritur potencialin e saj dhe për të kapërcyer kufizimet:

Iniciativat: Për të stimuluar zhvillimin bazë të mikrosigurimit, është e nevojshme që të sensibilizohet publiku i gjerë, politikbërësit, donatorët dhe agjencitë e zhvillimit, si dhe partnerët socialë dhe aktorët e tjerë të mbrojtjes sociale, për mënyrën se si punon mikrosigurimi dhe për kontributin e mundshëm për mbrojtjen sociale;

Ndërlidhja e skemave të ndryshme: Me ndërhyrjen e qeverisë, skemat e tjera të mikrosigurimit, (sigurimi shëndetësor dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve, institucionet e sigurimeve shoqërore, programet e ndihmës sociale) mund të forcojnë qëndrueshmërinë e skemave, si dhe të rrisin efektivitetin e tyre.

Përpjekjet: Për të përbushur potencialin e mbrojtjes sociale, mikrosigurimi duhet të shihet nga politikbërësit dhe palët e tjera të interesit brenda një konteksti më të gjerë të sistemeve koherente kombëtare të mbrojtjes sociale.

Duke qenë një marrëveshje e pavarur e menaxhimit të rrezikut, mikrosigurimi nuk është i mjaftueshëm për të mbrojtur shtresat e varfra nga rreziku. Duhet të konceptohet një strategji e integruar e mbrojtjes sociale në bashkëpunim me qeverinë, sektorin privat, profesionistët e shëndetësisë, partnerët socialë dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile. Mikrosigurimi mund të jetë më i suksesshëm nëse bashkon instrumente të tjera të menaxhimit dhe vlerësimit të rrezikut gjithëpërfshirës.

Për të përbushur potencialin e mbrojtjes sociale, mikrosigurimi duhet të shihet nga politikbërësit dhe palët e tjera të interesit brenda një konteksti më të gjerë të sistemeve koherente kombëtare të mbrojtjes sociale.

Megjithëse veprimet e skemave të mikrosigurimeve janë kryesisht të njëjta, pavarësisht nga objektivat e tyre, skemat e mikrosigurimit në kontekstin e mbrojtjes sociale duhet të vlerësohen dhe monitorohen ndryshe. Skemat e mbrojtjes sociale duhet të përfshijnë anëtarët me rrezik të lartë ose më të varfër dhe në mënyrë ideale të marrin subvencione publike për të kompensuar kërkesat më të larta ose kontributet më të ulëta. Nëse ata marrin subvencione publike, ata gjithashtu duhet të jenë përgjegjës, duke siguruar që këto fonde të përdoren në mënyrë efikase dhe për qëllimet e synuara.

Vendimi për të zbatuar ose për të mbështetur skemat e mikrosigurimit nuk nxitet vetëm nga një analizë e rrezikut, por edhe nga shqyrtimet politike: pasiguritë prioritare në mbulim, popullatat e synuara, rëndësinë e këtij mekanizmi në krahasim me të tjerët, dhe mundësinë për ta lidhur atë me mekanizmat e tjerë dhe komponentët e tjerë të mbrojtjes sociale. Qëllimi është të përmirësohet efikasiteti, të rritet mbulimi dhe të krijohen në mënyrë progresive sisteme më koherente dhe të barabarta të mbrojtjes sociale.

Britani

www.thesun.co.uk

Britanikëve do t'u nevojitet të aplikojnë për "Karton Jeshil" për të vërtetuar se makina e tyre është e siguruar kur të udhëtojnë në Europë, në rast se nuk do të ketë një marrëveshje për Brexit. Qeveria ka paralajmëruar qytetarët se mund të nevojitet një certifikatë e posaçme për mbulimin e mjetit me siguracion jashtë Britanisë, pasi në të kundërt mund të mos lejohen të drejtojnë mjetin, si edhe të gjobiten. Aktualisht, britanikët janë të mbuluar me siguracion ndaj palëve të treta në të gjithë vendet e BE-së. Qytetarët e vendeve të BE-së pritet të kenë të njëjtin problem nëse do të shkojnë në Britani, edhe pse ende nuk ka detaje sesi do të funksionojë siguracioni në këtë rast.

Greqi

www.xprimm.com

Siguruesit në Greqi kanë paguar mbi 33.7 milionë euro kompensim për zjarret shkatërrimtarë që goditën rajonin e Atikës në fund të korrikut, sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Kompanive Greke të Sigurimit. Në veçanti, pagesat për dëmtime në pronë llogariten në masën 32.4 milionë euro, me 785 raste të raportuara, me një mesatare prej 41,300 euro. Gjithashtu, janë raportuar mbi 212 raste të dëmtimit të makinave, për një shumë totale prej 1.3 milionë euro. Zjarret tragjikë shkaktuan mbi 90 viktima, ndërsa 200 shtëpi u shkrumbuan tërësisht.

Hungari

www.xprimm.com

Siguruesit në Hungari kanë raportuar një rritje të konsoliduar të primeve të shkruara bruto me vlerë 520.15 miliardë HUF (forinta, monedha vendase) për 6-mujorin e parë, me një rritje vjetore prej 7.1%. Megjithatë, duke marrë parasysh zhvlerësimin e monedhës vendase ndaj euros, nëse llogaritja bëhet me monedhën europiane, primet e shkruara bruto janë 1.58 miliardë euro dhe rritja e tregut është vetëm 0.6%. Rritjen më të madhe në treg e kanë shënuar sigurimet motorike. Gjithashtu në këtë segment edhe pagesa e dëmeve u rrit me 12%, më së shumti në siguracionet MTPL.

Kosovë

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Kosovë ka shënuar rritje me 5.9% referuar shifrave për 6 muajt e parë të vitit, të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Primet e shkruara bruto arritën në 45 milionë euro. Sigurimi i Jo-Jetës ka pjesën dominuese, me 43.5 milionë euro, ndërsa pjesa tjetër prej 1.5 milionë euro i mbetet sigurimit të Jetës. Përsa i përket dëmeve të paguara u shënuar një rënie e lehtë, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, nga 22.6 milionë në 22.3 milionë euro.

Kroaci

www.seenews.com

Primet e shkruara bruto në Kroaci për tetë muajt e parë të vitit 2018 arritën në 6.9 miliardë kuna (monedha vendase), ose 928.7 milionë euro, me një rritje vjetore në masën 10.43%. Primet e shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 9.95%, duke arritur në 4.73 miliardë kuna (636.5 milionë euro) për periudhën janar-gusht 2018. Segmenti i Jetës u rrit me 11.5% duke arritur në 2.17 miliardë kuna (292 milionë euro).

Mali i Zi

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto për 6-mujorin e parë të vitit në Mal të Zi arritën në 41.27 milionë euro, me një rritje prej 3.2%. Dëmet e paguara shënuan rritje me ritëm më të madh, 10.9%, duke arritur në 17.6 milionë euro. Sigurimi MTPL kishte rolin kryesor si në rritjen e primeve, ashtu edhe të dëmeve. Sigurimi i Jetës ruajti thujtë të pandryshuar përqindjen në treg, me 16.3%, me një rritje nën mesataren e tregut prej 2.24%. Sa i përket sigurimit të Jo-Jetës, në përgjithësi sigurimet motorike shënuan rritje me 15%. Rritje shënoi edhe sigurimi i pronës, me 10.9%.

Serbi

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Serbi e mbylli gjysmën e parë të vitit me prime të shkruara bruto në masën 52.18 miliardë RSD (dinari serb, monedha vendase) ose 442 milionë euro, me një rritje vjetore prej 6.8%. Gjatë 6-mujorit të parë 2018, tregu nuk ka pësuar shumë ndryshime, pasi pesha e segmenteve të Jetës dhe Jo-Jetës ka qëndruar pak a shumë e njëjtë, 22% Jeta, 78% Jo-Jeta. Rritjen më të madhe e ka shënuar sigurimi i pronës, në masën 11.8%. Gjithashtu edhe sigurimi motorik ka patur një ecuri të mirë, me 9.15% rritje.

Slloveni

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Slloveni u rrit me 6%, referuar të dhënave për primet e shkruara bruto për 6-mujorin e parë, duke arritur në 1.24 miliardë euro. Sigurimet e Jo-Jetës shënuan rritjen më të madhe, ashtu si edhe dëmet e paguara në këtë segment, që u rritën me 6.7%. Edhe sigurimi i Jetës u rrit me një normë mbi mesataren, me 8%, duke gjeneruar 355.8 milionë euro. Përsa i përket sigurimit të Jo-Jetës, sigurimi motorik dhe sigurimi i shëndetit shënuan rritjen më të madhe, me respektivisht 7.26% dhe 6.63%. Sigurimi i pronës solli një rritje të ndjeshme në pagesën e dëmeve. Kjo ndikuar nga kushtet ekstreme të motit në gjysmën e parë të vitit.

Turqi

www.xprimm.com

Shifrat e publikuara nga Shoqata e Siguruesve në Turqi tregojnë se sektori gjeneroi në total prime me vlerë 27.87 miliardë TRY (lira turke, monedha vendase) ose 5.24 miliardë euro, me një rritje prej 20.5%. Nëse do të merret në konsideratë inflacioni, atëherë rritja reale e sektorit ishte 4.4%. Rritjen më të madhe në 6-mujorin e parë e shënuan sigurimet MTPL, me 32.5%, duke arritur në 7.74 miliardë lirë prime të shkruara bruto. Edhe sigurimet KASKO u rritën me 13.2%, si edhe sigurimet e pronës me 16.72%.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al